



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 176 dt.26.08.1994

PER
REZULTATET E KONTROLL – REVIZIONIT EKONOMIKO – FINANCIAR
TE KRYER NE SHTYPSHKRONJEN “ÇAJUPI”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.27.08.1994, shqyrtoi njoftimin e përgatitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar e Kontroll – Revizionit “Për rezultatet e kontroll – revizionit ekonomik - financiar të kryer në shtypshkronjën “Çajupi”.

Vëren se :

Në kundërshtim me dispozitat përkatëse “Për blerjet dhe shërbimet jashtë sektorit shtetëror” drejtuesit e ndërmarrjes kanë blerë në sektorin privat lëndë të parë dhe materiale, pjesë makinerie etj, pa miratim të komisionit dhe pa siguruar oferta blerjeje të favorshme e të leverdisshme për ndërmarrjen. Disa nga këto blerje janë bërë direkt nga drejtuesit. Puna e kryer për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale dhe monetare nga Drejtuesit e Ndërmarrjes është bërë me të meta, dobësi, ka munguar organizimi, drejtimi dhe kontrolli financiar, nga i cili janë shkaktuar dëme ekonomike ndërmarrjes. Për sa më sipër, në mbështetje të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Këshilli Bashkiak

VENDOSI

1. Të merren masa të menjëherëshme për forcimin e kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes, për parandalimin e shkeljeve dhe të veprimeve të parregullta, sidomos për blerjet në sektorin privat.
2. Në mbështetje të ligjit Nr.7526, dt.03.12.1991, pika.”b” dhe “d”, “Për marrdhëniet e punës” Z. Xhemal Kaziu me detyrë drejtor i shtypshkronjës “Çajupi” të largohet nga puna për paaftësi në detyrë dhe veprime të parregullta
3. Ti propozohet ndërmarrjes që të largohet nga puna magazinierja Z. Nasibe Mazreku për veprime të parregullta në sektorin e magazinës.
4. Ky vendim të punohet në mbledhjen e zgjeruar të shtypshkronjës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen shtypshkronja “Çajupi”, Drejtoria e Administrimit Fianciar dhe Kontroll – Revizionit, Seksioni i Prognozës dhe Seksioni i Organizimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA